



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**MINISTRI**

Nr. 2756/6 Prot.

Tiranë, më 14/07/2013

**URDHËR**

Nr. 289 datë 11.7.2013

**PËR**

**AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT "MASTER I NIVELIT TË DYTË" TË  
UNIVERSITETIT "POLIS"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin e programeve të studimit "Master i Nivelit të Dytë" në:
  - a. "Dizajn urban dhe peisazhi"
  - b. "Strehim dhe zhvillim toke".në përputhje me vendimin nr. 470 datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
2. Akreditimi i programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, është i vlefshëm për studentët që kanë filluar studimet në këto programe në vitin akademik 2010-2011.
3. Universiteti "Polis", brenda 6 muajve nga dalja e këtij urdhri, të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin nr. 470 datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
4. Universiteti "Polis", do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
5. Urdhri të bëhet publik në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Polis".
7. Urdhri nr. 267, datë 28.06.2013 "Për akreditimin e programeve të studimit që përfundojnë me diplomat universitare "Master i nivelit të dytë" të universitetit "Polis" revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ



MINISTËR

